

VENDIM
Nr. 389, datë 6.5.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “UNAZA E MADHE TIRANË” (SEGMENTI KOPSHTI BOTANIK - SAUK I
VJETËR (SHITESAT))**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe Tiranë” (segmenti Kopshti Botanik - Sauk i Vjetër (shitesat)).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “arë” dhe “truall”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 75 195 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 3 940 (tre mijë e nëntëqind e dyzet) m², me vlerë 10 331 330 (dhjetë milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë) lekë;

b) tokë “truall”, me sipërfaqe 7 767.5 (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesë) m², me vlerë 64 864 353 (gjashtëdhjetë e katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë tokë “arë” dhe “truall”, prej 75 195 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE (PËR PUBLIKIM) QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS “UNAZA E MADHE TIRANË”,
 SEGMENTI “KOPSHTI BOTANIK - SAUK I VJETËR (SHITESAT)”

Nr.	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurie	Sipërfaqja (m²)	Sipërfaqe shpronësimi (m²)	Çmimi	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	QAZIM	HAXHI	BRARI	8270	8/324	Truall	1735	843	8,528	7,188,683	Konfirmuar
2	QAZIM	HAXHI	BRARI	8270	8/293	Truall	1265	307	8,528	2,617,943	Konfirmuar
3	B/PRONËSI BRARI			8270	8/382	Truall	65	45	8,528	383,738	Konfirmuar
4	B/PRONËSI BRARI			8270	8/292	Truall	1087	74	8,528	631,035	Konfirmuar
5	DRITA	(B.P)	SULCE	8270	8/405	Truall	281	74	8,528	631,035	Konfirmuar
6	BASHKIM	ISE	ULAJ	8270	8/404	Truall	281	101	8,528	861,278	Konfirmuar
7	LAVDIJE	FERIT	BAKALLI	8270	8/147	Truall	938	302	8,528	2,575,305	Konfirmuar
8	LAVDIJE	(B.P)	XHAJA	8270	8/146	Truall	1500	526	8,528	4,485,465	Konfirmuar
9	B/PRONËSI BRARI			8270	8/276	Truall	850	387	8,528	3,300,143	Konfirmuar
10	MEXHIT	HAMDI	BRARI	3292	153/133	Truall	320	320	8,528	2,728,800	Konfirmuar
11	B/P PETI			8280	1/394	Truall	3934.6	3191	8,528	27,211,253	Konfirmuar
12	MUHARREM	MEHMET	MUCA	3292	7/58	Are	3950	2940	2,622	7,709,165	Konfirmuar
13	DAFINA	(B.P)	POJANI	3292	354	Are	1000	1000	2,622	2622165	Bllokuar BNT
14	XHOVANE	HYSEN	GARUNJA	8280	1/86	Truall	1111.2	454	8,528	3871485	Proces konfirmimi
15	SOSE	VESEL	BOSHNJAKU	3266	75/49	Truall	880	7	2,622	18355.155	Proces konfirmimi
16	FERIT	RESHIT	BRAHJA	3266	75/75	Truall	1125	59.5	2,622	156018.8175	Proces konfirmimi
17	KRESHNIK		BRAHJA	3266	75/87	Truall	625	87	2,622	228128.355	Proces konfirmimi
18	SAMI		BRAHJA	3266	75/67	Truall	1177	25	2,622	65550	Proces konfirmimi
19	PERPARIM	SHYQYRI	HARIZI	3266	75/85	Truall	300	54	2,622	141588	Proces konfirmimi
20	NAZMI	JONUZ	PETI	8280	1/430	Truall	6000	911	8,528	7768552.5	Proces konfirmimi
	SHUMA							11707.5		75,195,683	